



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjiilan, me datë: 23.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të dt. 07.02.2023 të parashtruar nga: *OE N.T.SH.AtomMed O.P* " lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material laboratorik " me nr. identifikues 651-23-215-1-1-1dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GI 651 001 23 111nxjerr:

### V E N D I M

**Refuzohet** – kërkesa për rishqyrtim e *OE N.T.SH.AtomMed O.P* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Furnizim me material laboratorik " Lot 3. "Reagensa dhe material shpenzues per laborator" me nr. identifikues 651-23-215-1-1-1dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GI 651 001 23 111 e datës 23.03.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 14.03.2022 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. AK - Komuna e Gjiilanit vendosë të vazhdojë sipas Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 14.03.2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

### A r s y e t i m

*OE N.T.SH.AtomMed O.P* ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Furnizim me material laboratorik " Lot 3. "Reagensa dhe material shpenzues per laborator" me nr. identifikues 651-23-215-1-1-1dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GI 651 001 23 111 . Autoriteti Kontraktues me datë 23.03.2023 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga *OE N.T.SH.AtomMed O.P* "

Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjiilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara pasi që:

## Sipas pretendimit ankimor nr.1 –

Kërkesat të cilat kanë qenë kriter për me u plotësu për Lot 3 “Reagensa dhe materiale shpenzuese për Laborator “

- Të gjithë reagjentet hematologjik duhet të jenë original përpaisjet e kërkuara.
- Paketimet e reagjenteve biokimi duhet të jenë sipas listës, Paketimet me sasi 20,10 apo 5 ml, sasi të vogla .
- Aplikacionet për futjen e reagjenteve apo instalimin e tyre në pasije duhet të dorzohen në ofertë.

Me datën 16.03.2023 ne kemi pasur qasje në dokumenta zyrtare për fituesin Bio-Labvleren 49,964.02€. Gjatë vlersimit të dokumentave të prezantuara nga fituesi pretendues ne kemi hasur në disa dokumente të cilat nuk janë ashtu siq janë kërkuar në kriteret më nëaltë që i kemi cakur siq janë:

*Pika 1 – Biolab ka dërguar aplikacionin të Selecteres XS dhe Flexor EL 80 të cilat nuk gjenden në treg nga prodhuesi sepse janë sepse janë paisje të vjetra, të cilat nuk janë në prodhim dhe Aplikacionet të dërguara nga BioLab janë Softverin e vjetër VI ndërsa Selectra ProM nuk mund të futet në aplikacion /përdorim*

Andaj në bazë të kësaj që ka prezantuar për reagensa Origjinale dhe me ml siq është kërkuar për reagensat Origjinale dhe me mk siq janë kërkuar në kriterin nga Autoriteti Kontraktues .

Dokumenti i prezantuar nga OE nuk është ajo që është kërkuar nga AK, andaj në bazë të kësaj OE pretendues i shpallur fitues duhet të rishqyrtohet seriozisht pasi që është në kundërshtim me atë që është kërkuar dhe ofruar.

Reagencat tona të ofertuara janë origjinale ashtu siq janë kërkuar, pasi që ne jemi Përfaqësues të Autorizuar për Kosovë për Elitech për paisje dhe Reagensat.

Andaj kërkojmë nga ju që të veproni në bazë të kritereve të vendosura pasi që me këto aplikacione të paraqitura mund të vjen deri të prishja e paisjes pasi që Sowtwei i Selectrea Pro është versioni i fundit dhe gjdo gjë tjetër e vendosur në të mund të jetë e demshme për paisjen dhe mbartvajtjen e saj e mos të flasim për rezultatet të pacienteve të cilat mund të jenë komplet të devijuara

Dëshmia : Aplikacionet e dërguara nga OE Bio-Lab

Pika 2. Për reagensat Hematologjik në Lot 3 janë reagensat SFRI H18, nga prodhuesi i SFRI SRL me seli në Francë e me përfaqësues për Kosovë AtomMed.

Ofertat nga Biolab për reagensat Origjinal për Hematologji, nuk është ajo që është kërkuar, pasi që nuk janë origjinale janë nga prodhuesi NeoMedica, e cila nuk është prodhuesi por diler shites në Serbi, për rajonin e Ballkanit

Andaj dhe këto reagensa që i ka ofertu nuk janë origjinale në bazë të kritereve të vendosura nga AK.

Në kemi ofruar reagensat Origjinale jo kompatible, pasi që vendosja e reagensave tjera përpos origjinale është e demshme për paisjen dhe për rezultatet e pacienteve .

Deshmia ,Catallogu nga Oe i shpallur nga ju .

Në bazë të kësaj ne kërkojm qe te vlersohet kriteret te cilat jan shum te rendesishme ne nje ofert te till dhe jo vetem cmimi i lir i icli mund te jet me pasoja te madhe per paisjen dhe rezultatet perfundimtare.

**Përgjigjia e AK lidhur me pretendimin e juaja ankimor është se:**

**Autoriteti Kontraktues konstaton se ky pretendim ankimor është i pa bazuar, pa fakte dhe nuk qëndron pasi që:**

**Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, komisioni ka konstatuar se Oferata e dorëzuar nga OE I rekomanduar që të shpërblehet me kontratë, sa i përketë kërkesave AK lidhur me:**

### **Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

#### **Lot 3. Reagensa dhe material shpenzues per laborator**

- **Të gjithë reagjentet homatologjik duhet të jenë original përpaisjet e kërkuara.**
- **Paketimet e reagjenteve biokimi duhet të jenë sipas listes ,Paketimet me sasi 20,10 apo 5 ml ,sasi të vogla .**
- **Aplikacionet per futjen e reagjenteve apo instalimin e tyre ne pasije duhet te dorzohen ne ofert.**

**Pasi që OE i rekomanduar që të shpërblehet me kontratë ka ofruar Aplikacionet të Selecteres XS dhe Flexor EL 80 e kërkuara sipas kërkesës së AK.**

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

**Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Shqipe Hoxha**



**Menaxher i zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës.